



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar
Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • http://www.nocalbania.org.al

D1 14/02/2020
Nr 40 PRD

Tiranë, 09 Shkurt 2019

**Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të 22-të e Jashtëzakonshme
e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar**

Pas rekomandimeve të IOC / EOC, të gjitha palët pranuan që misioni kryesor i KOKSH tani është: të përqendrohet në përgatitjen e Delegacionit për pjesëmarrje në Lojërat Olimpikë Tokio 2020. Prandaj, është rënë dakord për të ruajtur status quo-në e anëtarëve të zgjedhur aktual të Komitetit Ekzekutiv deri pas Lojërave Olimpikë në Tokio kur zgjedhjet do të zhvillohen sipas ciklit të rregullt zgjedhor. Megjithatë, ndërkohë, është rënë dakord që të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv duhet të respektojnë kushtet e mëposhtme:

1. Nuk duhet të ketë pretendime ose deklarata të mëtejshme publike kundër njëri-tjetrit dhe çdo çështje duhet të trajtohet brenda organizatës nga organet drejtuese kompetente të KOKSH.

2. Organet drejtuese dhe hierarkia vendimmarrëse duhet të respektohen si më poshtë:

- a. Asambleja e Përgjithshme si organi suprem vendimmarrës
- b. Komiteti Ekzekutiv

Askush duke përfshirë Presidentin ose ndonjë zyrtar/anëtar tjetër i Komitetit Ekzekutiv nuk mund të marrë vendime individuale ose të njëanshme, dhe të gjitha vendimet e marra nga organet drejtuese të përmendura më lart duhet të respektohen.

3. Asnjë veprim tjetër ligjor nuk duhet të ndërmerret kundër njëri-tjetrit brenda Komitetit Ekzekutiv ose edhe kundër Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Raportet financiare dhe të auditit të miratuara zyrtarisht nga Asambleja e Përgjithshme e fundit në Shtator 2019, nuk duhet t'i nënshtrohen ndonjë diskutimi të mëtejshëm. Sidoqoftë, rekomandimet e bëra nga auditit duhet të ndiqen dhe zbatohen.

5. Duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme për të rihapur llogaritë bankare të KOKSH për të siguruar funksionimin normal të tij.

6. Statuti do të ndryshojë pas Lojërave Olimpikë nga një Komitet Teknik i përbërë prej përfaqësuesve të: Asamblesë së Përgjithshme, Ministrisë së Sporteve, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe Komitetit Olimpik European. Drafti përfundimtar do të miratohet nga IOC dhe do t'i paraqitet për votim Asamblesë së Përgjithshme. Pas miratimit të Asamblesë, do të zhvillohen zgjedhjet e KOKSH në përputhje me Statutin. Ky process do të përfundojë deri në fund të Dhjetorit 2020.

Është rënë dakord reciprokisht që kushdo që do të shkelë ndonjë prej këtyre kushteve do të përjashtohet menjëherë me vendim përfundimtar të Asamblesë së Përgjithshme.

Viron Bezhani

President



Stavri Bello

Sekretar i Përgjithshëm